Sipas shkrimit të medieve ndërkombëtare, të cilat i referohen burimeve të Agjencisë Kozmike Amerikane NASA, nuk është larg dita kur Dielli do të lind nga Perëndimi në vend se nga Lindja. “ Daily Mail” dhe „ Huffington post“ raportuan për të dhënat serioze dhe faktike shkencore që ka NASA dhe Agjencia Kozmike Evropiane për kthesën e madhe të llojit të vet që do të pësojë poli magnetik e që për pasojë do të ketë lindjen e Diellit nga ana Perëndimore. Revista amerikane ”Live Science” thekson se poli magnetik i Tokës nuk është aq i fuqishëm sa ka qenë në të kaluarën dhe është dobësuar për dhjetë herë më shumë, kurse ky dobësim ka marrë përmasa më të mëdha këto gjashtë muajt e fundit. Faktin e hidhur të ndryshimit që ka pësuar poli magnetik e ka konfirmuar edhe Agjencia Kozmike Evropiane, e cila po ashtu ka vërtetuar se kjo do të thotë se Dielli do të lind nga Perëndimi. Siç dihet lindja e Diellit nga Perëndimi është përmendur në hadithin e Muhamedit alejhiselam si shenjë e madhe e Ditës së Kijametit. Ndërsa Allahu në Kuran thotë: “Hëna është çarë dhe Kijameti është afruar” (El Kamer 1), “Njerëzve u është afruar Kijameti, por ata të hutuar në pakujdesi nuk përgatiten fare për të”, (El Enbija 1) etj.

Burimi: NASA: “KIJAMETI NUK ËSHTË LARG – DIELLI DO TË LIND NGA PERËNDIMI”

Phoca PDF